



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2436, datë 24.03.2014

Për

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Iris Xhanaj, në mbledhjen e datës 24.03.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, i ndryshuar;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacion shpjegues mbi *Projekt-Vendimin (Relacioni)*;
2. *Projekt Raport* i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013 (*Përmbajtja*);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Raporti i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i hartuar mbi raportimet e të gjitha Drejtorive në përbërje të AKEP për vitin 2013 i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 9 të ligjit nr. 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit “AKEP-i është përgjegjës për punën e tij përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” dhe “Në përfundim të çdo viti, AKEP-i paraqet në Kuvend, brenda katër muajve të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit pararendës.

Raporti në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim përmban në mënyrë të veçantë:

- Raportin e punës së AKEP për vitin 2013 ;
- Programin vjetor të punës për vitin 2014;
- Raportin për statusin e shërbimit universal; dhe
- Raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP.

Edhe për vitin 2013 parimi bazë i veprimtarisë sektoriale të AKEP-it në aspektin rregullator ka qenë sigurimi i një mjedisi biznesi të qartë dhe të parashikueshëm për funksionimin e sipërmarrësve dhe investimeve të rëndësishme; krijimit të kushteve për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në tërë territorin e Shqipërisë, nëpërmjet nxitjes së përdorimit racional dhe eficient të burimeve të kufizuara (frekuencave dhe numeracionit); nxitjes së konkurrencës dhe parandalimit të deformimit të konkurrencës në treg ndërmjet operatorëve; zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të përmirësimit të qëndrueshëm e të vazhdueshëm të mbrojtjes së interesave të përdoruesve.

Për kryerjen sa më mirë të rolit dhe funksioneve të AKEP-it si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe fushës së shërbimit postar, ushtrimi i veprimtarisë është udhëhequr nga parimi i zbatimit sa më rigoroz të ligjshmërisë duke i ushtruar kompetencat në përputhje të plotë me sanksionimet ligjore, si dhe duke i zbatuar të drejtat dhe detyrimet institucionale të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator të fushës, për realizimin me sukses të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin sektorial, Rezolutën e

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Godina Torre Drin, Kati IX, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

www.akep.al

Fax : + 355 4 2259 106

info@akep.al

Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2012” si dhe Raportit të Progresit për Shqipërinë të KE, për vitin 2012.

Plotësimi i kërkesave të Kuvendit pasqyruar nëpërmjet Rezolutës (R. 64/2 Prot., datë 06/05/2013) “Për vlerësimin e veprimtarisë së AKEP për vitin 2012”, i konsideruar si një program pune ka orientuar veprimtarinë e AKEP-it për vitin 2013, të përshkruar në mënyrë analitike në përmbajtjen e njëmbëdhjetë pikave të pasqyruara në *projekt Raport*.

Me qëllim raportimin e veprimtarisë së punës së vitit pararendës të AKEP përpara institucionit të Kuvendit të RSH dhe garantimin e disponibilitetit dhe transparencës për publikun të kësaj veprimtarie rregullatore,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në nenin 9, pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918/2008,

V E N D O S:

1. Të miratojë Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013, *sipas dokumentit bashkëngjitur*;
2. Të dorzojë në Kuvend Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013 brenda datës 31.03.2014;
3. Një kopje e këtij Raporti ti dërgohet Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R
PIRO XHIXHO**

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

